



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 259, datë 24.05.2023

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË PEZULLIMIT ME NR. 642, DATË 23.12.2020,
“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR PASJE/NJOHJE TË STATUSIT TË
KËSHILLTARIT/NDIHMËSIT LIGJOR JOMAGJISTRAT
PRANË GJYKATËS SË LARTË TË Z. {...}”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 97, 98 dhe 100, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 165, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 68/2, të Kodit të Procedurës Administrative, në propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit;

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të pezullimit me nr. 642, datë 23.12.2020, të KLGj-së “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë gjykatës së lartë të z. {...}”.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR